

Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo

Nr/Br.

37121

Datë/Datum.

01.03.21 ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT
TELO ZA RAZMATRJE NABAVKE
PRISHTINË - PRISTINA
PROCUREMENT REVIEW BODY

PSH.nr. 37/21

PANELI SHQYRTUES, i emëruar nga Kryetari i OSHP-së, në bazë të nenit 105 dhe nenit 106 të Ligjit për Prokurim Publik të Kosovës nr. 04/L-042, i plotësuar dhe ndryshuar me Ligjin 04/L-237, Ligjin 05/L-068 dhe Ligjin 05/L-092, në përbërje të Blerim Dina - Kryetar, panelist individual, duke vendosur sipas ankesës së parashtruar nga operatori ekonomik “Infinit” SH.P.K-Prishtinë, kundër njoftimit për dhënie të kontratës, ku është rekomanduar për kontratë OE “I.T. Market” SH.P.K.-Prishtinë, lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull “Furnizimi i shkollave me tabela interaktive” me nr. të prokurimit VU644-20-7889-1-2-1, iniciuar nga Autoriteti Kontraktues - “KK-Vushtrri”, më datën: 25.02.2021, mori këtë:

V E N D I M

I. APROVOHET, pjesërisht si e bazuar ankesa e operatorit ekonomik “Infinit” SH.P.K-Prishtinë, kundër njoftimit për dhënie të kontratës, lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull “Furnizimi i shkollave me tabela interaktive” me nr. të prokurimit VU644-20-7889-1-2-1, iniciuar nga Autoriteti Kontraktues - “KK-Vushtrri”.

II. ANULOHET, njoftimi për dhënie të kontratës lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull “Furnizimi i shkollave me tabela interaktive” me nr. të prokurimit VU644-20-7889-1-2-1, iniciuar nga Autoriteti Kontraktues - “KK-Vushtrri” dhe anulohet në tëresi ky aktivitet i prokurimit.

III. Autoriteti Kontraktues në afat prej 10 ditësh duhet ta informoj me shkrim Panelin Shqyrtues për të gjitha veprimet e ndërmarra lidhur me këtë aktivitet të prokurimit.

IV. Mos respektimi i këtij vendimi, detyron Panelin shqyrtues që konform dispozitave ligjore të nenit 131 të Ligjit për Prokurim Publik të Kosovës nr. 04/L-042, i plotësuar dhe ndryshuar me Ligjin 04/L-237, Ligjin 05/L-068 dhe Ligjin 05/L-092, të ndërmarr masa ndaj Autoritetit Kontraktues.

V. Me qenë se ankesa e operatorit ekonomik ankues “Infinit” SH.P.K-Prishtinë, aprovohet pjesërisht si e bazuar, i bëhet kthimi i tarifës së ankesës në shumën e deponuar me rastin e parashtrimit të ankesës.

VI. Obligohet operatori ekonomik ankues që konform nenit 31 pika 6 të rregullores së punës së OSHP-së, në afat prej gjashtëdhjetë (60) ditësh të bëjë kërkesë për kthim të sigurimit të ankesës, në të kundërtën ju bëhet konfiskimi i depozitës dhe këto mjete kalojnë në Buxhetin e Republikës së Kosovës.

A R S Y E T I M

Operatori ekonomik ankues “Infinit” SH.P.K-Prishtinë, si palë e pa kënaqur ka deponuar ankesën me nr. 37/21 në OSHP, me datë 11.01.2021, kundër njoftimit për dhënie të kontratës, lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull “Furnizimi i shkollave me tabela interaktive” me nr. të prokurimit VU644-20-7889-1-2-1, iniciuar nga Autoriteti Kontraktues - “KK-Vushtrri”, duke pretenduar se:

- Autoriteti kontraktues ka vepruar në kundërshtim me nenin 1, 6, 7, 29, 59, 60 dhe nenin 69 të Ligjit për Prokurimin Publik të Republikës së Kosovës, si dhe nenin 4.1, 41, 60 UOPP-së, nen 4 i RRPA-së dhe 4.1 FDT-së.

Organi Shqyrtues i Prokurimit, konform nenit 113 dhe 114 të LPP-së me datë: 14.01.2021, ka autorizuar ekspertin shqyrtues të prokurimit për të shqyrtuar vlefshmërinë e të gjitha pretendimeve të palës ankimore.

Eksperti shqyrtues i prokurimit në raportin e datës 03.02.2021, lidhur me pretendimin ankimore të OE ankues sqaron si në vijim:

Pas shqyrtimit në detaje të lëndës së tenderit lidhur me këtë aktivitet të prokurimit dhe duke u bazuar në dokumentacionin në dispozicion, eksperti shqyrtues jep këtë mendim si në vijim:

Sa i përket pretendimeve ankimore të OE ankues ku thuhet që OE i rekomanduar për kontratë nuk ka dorëzuar dëshmitë dokumentare sipas kërkesës në Aneks 1, gjegjësish autorizimin e prodhuesit, garacionin 5 vjeçar të pajisjeve dhe nuk figuron që OE i rekomanduar për kontratë është prodhuesi i pajisjeve të ofertuara, Eksperti Shqyrtues jep këtë mendim si në vijim:

- Konform nenit 59 të LPP-së, Autoriteti kontraktues do të konsiderojë një tender si të përgjegjshëm vetëm nëse tenderi në fjalë është në përputhshmëri me të gjitha kërkesat e parashtruara në njoftimin e kontratës dhe në dosjen e tenderit. Një gjë e tillë është po ashtu e specifikuar dhe në nenin 28.6 të RRUOPP-së ku thuhet që “Kriteret e dhënies të përzgjedhura duhet të specifikohen në Njoftim për Kontratë dhe në Dosje të Tenderit”. Për më tepër, konform nenit 18.4 të RRUOPP-së, ndër të tjerash thuhet që kërkesat e përcaktuara në Dosjen e tenderit dhe në njoftimin për kontratë duhet të janë identike. Një interpretim të njëjtë e jep edhe KRPP në bashkëbisedim e sipër me Koordinatoren e

Departamentit të Rregullave pas kërkesave për interpretim të parashtruar nga Eksperti Shqyrtues. • Si rezultat i interpretimit të lartpërmendur, kërkesat sikurse autorizimi i prodhuesit, garacioni 5 vjeçar dhe afati i liferimit prej 10 ditësh nuk janë përcaktuar nga Autoriteti Kontraktues në FDT dhe Njoftim për Kontratë dhe nuk mund të merren si kritere të kualifikimit dhe përgjedhjes nga AK. Konform nenit 41.3 të RRUOPP-së tek parimet kryesore të procedurës së vlerësimit sipas LPP, vetëm kërkesat dhe kritere e dhënies së kontratës të specifikuara në njoftim për kontratë/dosje të tenderit mund të përdorën si bazë për vlerësim. Si të tilla “Kriteret e përshtatshmërisë” dhe “kërkesat minimale të kualifikimit” së bashku karakterizohen si “Kritere të Përgjedhjes” kërkesa këto që një OE duhet të përbushë për të konsideruar i kualifikuar për dhënie të kontratës publike të cilat do të specifikohen qartë në njoftimin për kontratë dhe në dosje të tenderit, si dhe, çdo dokument apo informatë tjeter që OE i interesuar kërkohet të dorëzoj në mënyrë që të konsiderohet i kualifikuar. • Eksperti Shqyrtues vlerëson që Autoriteti Kontraktues është dashur që dëshmitë mbi përshtatshmërinë profesionale të përcaktuar me nenin 66 të LPP-së – Përshtatshmëria Profesionale, t'i përcaktojë konform dispozitave ligjore në fuqi dhe të strukturohen në mënyrë të tillë që të vërtetohen nga operatorët ekonomikë. Vendosja e kërkesave jo në përputhshmëri me LPP-në ka rezultuar në një jo-trajtshmëri të ofertave të pranuara duke pamundësuar një vlerësim objektiv të operatorëve pjesëmarrës sikurse kërkohet në nenin 59 të LPP-së. Duke marrë parasysh që një një shkelje e ligjit aktual ka ndodhur apo do të ndodhë në procedurën e prokurimit, e cila nuk mund të rregullohet apo të parandalohet përmes një amendamenti ligjor të kushteve të prokurimit, duke përfshirë edhe rastet ku një dispozitë e këtij ligji kërkon anulimin e aktivitetit të prokurimit, konform nenit 62 të LPP-së, Eksperti Shqyrtues rekomandon që ky aktivitet i prokurimit të anulohet dhe nëse AK ka nevojë ta ri-iniciojë një aktivitet të tillë në të ardhmen. Duke marrë parasysh përshkrimin dhe faktet e lartpërmendura dhe pas shqyrtimit të shkresave të lëndës, kronologjinë e rastit në fjalë dhe natyrën e pretendimeve, Eksperti shqyrtues e sheh ankesën e operatorit ekonomik ankues si të pjesërisht të bazuar, duke sugjeruar kështu që vendimi i Autoritetit Kontraktues për aktivitetin e prokurimit numër “644-20-7889-1-2-1”, respektivisht atij me titull “Furnizimi i shkollave me tabela interaktive”, iniciuar nga AK – Komuna e Vushtrrisë, të anulohet dhe të anulohet në tërësi ky aktivitet i prokurimit..

Mendimi i ekspertit shqyrtues: Bazuar në sqarimet e lartpërmendura, eksperti shqyrtues i propozon panelit shqyrtues që ankesa e OE ankues duhet të jetë: pjesërisht e bazuar dhe të anulohet aktiviteti i prokurimit.

Organë shqyrtues i prokurimit i ka njoftuar palët me datë: 04.02.2021 me raportin e ekspertizës.

Autoriteti kontraktues me datë 12.02.2021, me anë të parashtresës ka njoftuar OSHP-në si me poshtë:

From: Prokurimi Vushtrri <prokurimi.vushtrri@rks-gov.net>

Sent: 12/Feb/21 13:36

To: OSHP <oshp@rks-gov.net>; INFINITT SHPK <infinitshpk@hotmail.com>; infinit.shpk@gmail.com

Cc: Ardian Behra <Ardian.Behra@rks-gov.net>; Blerim Dina <Blerim.Dina@rks-gov.net>; Nuhi Paqarizi

<Nuhi.Paqarizi@rks-gov.net>; Goran Milenovic <Goran.Milenovic@rks-gov.net>; Dior Halili

<Dior.Halili@rks-gov.net>

Subject: RE: 37/21 eksp

Të nderuar,

Ju shkruaj lidhur me aktivitetin e prokurimit te inicuar nga ne si A.K me titullin: "Furnizimi i shkollave me tabela interaktive" me Nr. Prok.: 644-20-7889-1-2-1,

Aktivitet I cili eshte I inicuar ne fund te vitit 2020, por i cili per shkak te ankeses se nje O.E nuk eshte arritur te finalizohet. Tani qe po ju shkruaj jemi para nje situate te re sepse nga njesia inicuese (Drejtoria e Arsimit) kemi nje shkres me te cilen na njoftojn se nuk e kane te planifukuar nje shpenzim te till dhe rrjedhimisht as nuk kane mbulushmeri buxhetore per te realizuar nje kontart si kjo. Andaj, ne si Prokurim jemi para marrjes se vendimit per te anular si process kete aktivitet te prokurimit sepse nuk mund te vijim deri te kontrata pa mbulushmeri buxhetore, rrjedhimisht vazhdimi I me tejm me kete aktivitet do perbente ne vete shkele te ligjit. Pra, permes ketij e-maili ju njoftoj se jemi ne nje situate te re e cila sipas te gjitha gjasave do te na detyron te anulojm ne tersi kete process, Andaj po ashtu si A.K pajtohem me mendimin e Ekspertit te OSHP-së te dhene ne ekspertizen e tij me Nr. 37/21 – Pranuar nga A.K – Vushtrri 03.02.2021, permes e-mailit.

Me respekt!

DPP – VU

Operatori ekonomik "Infinit" SH.P.K-Prishtinë, me datë 05.02.2021, me anë të parashtresës ka njoftuar OSHP-në se pajtohet pjesërisht me mendimin e ekspertit shqyrtues.

Seanca dëgjimore është mbajtur me datën 15.02.2021, nëpërmjet platformës elektronike ZOOM për shqyrtimin kryesor të ankesës së OE "Infinit" shpk me nr. 37/21, kundër vendimit të AK-“KK Vushtrri”, lidhur me aktivitetin e prokurimit "Furnizimi I shkollave me tabela interaktive" me nr. prokurimit: VU644-20-7889-1-2-1, Kryetari i panelit hapi seancën e shqyrtimit kryesorë të ankesës te mbajtur ne ZOMM në ora 10:00, ku mori pjesë si panelist individual, përfaqësuesit e OE-së ankues, eksperti shqyrtues ndërsa përfaqësuesit AK-së nuk ka qen prezent ne seancë.

Kryetari i panelit i njoftoi të pranishmit me përbërjen e panelit, dhe pasi konstatoi se nga të pranishmit nuk pati vërejtje në këtë përbërje, vazhdoi me seancën.

Kryetari i panelit i njoftoi të pranishmit me objektin e shqyrtimit si dhe me shkresat e lëndës dhe në vazhdim fjalën ia dha përfaqësuesit të OE-së ankues i cili deklaroj : ne qëndrojmë ne tersi pran ankesës tone te dorëzuar te dorëzuar ne OSHP me 11.01.2021 siç e kemi cek edhe me imell me datës 05.02.2021 pajtohem i pjesërisht me mendimin e ekspertit shqyrtues, AK ka ber shkelje te dispozitave te ligjit te prokurimit publik dhe udhëzimit operativ te prokurimit publik dhe ka rekomanduar për kontratë OE te pa përgjegjshëm i cili nuk plotëson kërkesat e parashtruara ne kontratë dhe ne dosjen e tenderit si dhe ne ofertë ka paraqitur variantet e specifikave teknike dhe po ashtu ne veb faqe nuk mund te verifikohet se prodhuesit i smartbordit te ofruar është kompania ajtimaket ashtu siç ka deklaruar OE dhe katalogi i dorzur OE nuk hapen ne veb faqen e prodhuesit dhe nuk mund te gjinden ne internet ne ketë menyr nuk mund te verifikohet se produkti i oferua nga OE ne fjalë i polotso specifikat teknike te dosjes se tenderit. Arsyetimi me 12 shkurt i derguar nga AK – së KK Vushtrri se se për kete projekt nuk kan bujshmeri te buxhetit me duket i vonshem dhe nënkupton se ne rast se dot e mbetej ne fuqi vendimi i AK se ku eshte rekomanduar për kontratë OE tjetër do te vazhdoj me implementimin e projektit. Kerkojm nga paneli shqyrtues qe pas shoshitjes se provave dhe fateve ta aprovoj aneksen tone si te bazuar lenda te kthehet ne rivlerësim deh AK Vushtrri gjatë faqes se rivlerësimit te respektoj dispozitat ligjore te lart cekura dhe ne harmoni me nenin 60 te LPP-së qe te shpërblej me kontratë kompaninë tone si i pergjegjshum me çmimin m e te ulet.

Ne fjalën përfundimtare Eksperti deklaroj : problemi oshtë qe AK kriteret e përzgjedhjes qe pe zam i kritereve te përshtatshmërisë edhe kriteret minimale për kualifikimi ka vendos ne aneks 1 do te thotë është një shrim qe rezulton ne një shkelje te nenin 59 te LPP së edhe 18.4 te RRUOPP-së ku kërkesat e plotsumem ne dosjen e tenderit duhet me qen identike me njoftim për kontratë dhe ka te bez me disa kërkesa te cilat ja vendos ne aneks 1 por nuk janë vendos ne FDT dhe kjo ka rezulto le te themi n enjo jo trajtshmeri te te dërgimit te ofertave disa pre OE i kanë marr ato kërkesa si te mirqenna për fatin qe i kanë marr sikurse qe janë te vendosura ane FDT ndërsa disa te tajer nuk kanë ofertu konform kërkesave te tyre dhe besoj qe për faktin se vendosja e kërkesave qe janë jo ne perputhshemri me LPP ka rezulto ne edhe ka vendos ne lajthitje OE qe kanë qe pamundëson objektiv te OE pjesëmarrës andaj edhe për faktin qe është shkel edhe për faktin qe është shkel nen 66 qe është dashtë edhe qmim dhe përshtatshmëri profesionale te përcakta ne nen 66 te përshtatshmëria profesionale përcakton konform dispozitave ligjore e jo ato kërkesa te shënohen ne aneks 1 por te shënohen aty ku duhet ne FDT dhe te jan identike me kërkesat për kontratë pikërisht për ketë arsyetim kam ardh ne një rekomandim.

Lidhur me ankesën e OE ankues “Infinit” SH.P.K-Prishtinë, Paneli Shqyrtues pas shqyrtimit në detaje të lëndës së tenderit lidhur me këtë aktivitet të prokurimit dhe duke u bazuar në dokumentacionin në dispozicion, sqaron se pretendimet ankimore të OE ankues kanë të bjënë me OE të rekomanduar për kontratë, duke pretenduar se OE i rekomanduar për kontratë nuk ka dorëzuar dëshmitë dokumentare sipas kërkesës në Aneks 1, gjegjësisht autorizimin e prodhuesit, garanci 5 vjeçare të pajisjeve dhe nuk figuron që OE i rekomanduar për kontratë është prodhuesi i pajisjeve të ofertuara.

Paneli Shqyrtues konform ekspertit shqyrtues sqaron se AK në pajtim me nenin 59 të LPP-së, do të konsiderojë një tender si të përgjegjshëm vetëm nëse tenderi në fjalë është në përputhshmëri me të gjitha kërkesat e parashtruara në njoftimin e kontratës dhe në dosjen e tenderit. Një gjë e tillë është po ashtu e specifikuar dhe në nenin 28.6 të RRUOPP-së, ku thuhet që “Kriteret e dhënies të përzgjedhura duhet të specifikohen në Njoftim për Kontratë dhe në Dosje të Tenderit”. Për më tepër, konform nenit 18.4 të RRUOPP-së, ndër të tjerash thuhet që kërkesat e përcaktuara në Dosjen e tenderit dhe në njoftimin për kontratë duhet të janë identike. Rrjedhimisht, kërkesat sikurse autorizimi i prodhuesit, garancia 5 vjeçare dhe afati i liferimit prej 10 ditësh nuk janë përcaktuar nga Autoriteti Kontraktues në FDT dhe Njoftim për Kontratë dhe nuk mund të merren si kritere të kualifikimit dhe përzgjedhjes nga AK. Konform nenit 41.3 të RRUOPP-së tek parimet kryesore të procedurës së vlerësimit sipas LPP, vetëm kërkesat dhe kritere e dhënies së kontratës të specifikuara në njoftim për kontratë/dosje të tenderit mund të përdorën si bazë për vlerësim. Si të tilla “Kriteret e përshtatshmërisë” dhe “kërkesat minimale të kualifikimit” së bashku karakterizohen si “Kritere të Përzgjedhjes” kërsa këto që një OE duhet të përbushë për të konsideruar i kualifikuar për dhënie të kontratës publike të cilat do të specifikohen qartë në njoftimin për kontratë dhe në dosje të tenderit, si dhe çdo dokument apo informatë tjeter që OE i interesuar kërkohet të dorëzoj në mënyrë që të konsiderohet i kualifikuar. Gjithashtu, Paneli Shqyrtues skonform ekspertit shqyrtues vlerëson që autoriteti kontraktues është dashur që dëshmitë mbi përshtatshmërinë profesionale të përcaktuар me nenin 66 të LPP-së t'i përcaktojë konform dispozitave ligjore në fuqi dhe të strukturohen në mënyrë të tillë që të vërtetohen nga operatorët ekonomikë. Vendasja e kërkesave jo në përputhshmëri me LPP-në ka rezultuar në një trajtshmëri të ofertave të pranuara duke pamundësuar një vlerësim objektiv të operatorëve pjesëmarrës sikurse kërkohet në nenin 59 të LPP-së.

Paneli shqyrtues pas shqyrtimit të shkresave të lëndës, shqyrtimit të pretendimeve ankimore të OE ankues, konstatimeve, analizës konkrete dhe rekomandimeve të ekspertit shqyrtues, deklarimit të palëve në procedurë, diskutimeve dhe shoshitjes së provave në tërësi, vjen në përfundim se duke pasur parasysh që një shkelje e ligjt aktual ka ndodhur apo do të ndodhë në procedurën e prokurimit, e cila nuk mund të rregullohet apo të parandalohet përmes një amendamenti ligjor të kushteve të prokurimit, duke përfshirë edhe rastet ku një

dispozitë e këtij ligji kërkon anulimin e aktivitetit të prokurimit, konform nenit 62 të LPP-së, Paneli Shqyrtaues vlerëson që ky aktivitet i prokurimit duhet të anulohet dhe nëse AK ka nevojë ta ri-iniciojë një aktivitet të tillë në të ardhmen.

Paneli shqyrtaues konform nenit 117 të LPP-së, si dhe duke u bazuar në provat e prezantuara si më lart vendosi si në dispozitë të këtij vendimi.

KËSHILLË JURIDIKE:

Kundër këtij vendimi nuk është e lejuar ankesa, por pala e pakënaqur me kërkesëpadi mund t'i drejtohet Gjykatës themelore-Departamentit për çështje Administrative në afat prej 30 ditësh nga data e pranimit të këtij vendimi.



Vendimi t'i dorëzohet:

- 1x1 AK "KK-Vushtrri";
- 1x1 OE "Infinit" SH.P.K-Prishtinë;
- 1x1 Arkivës së OSHP-së;
- 1x1 Për publikim në ueb-faqe të OSHP-së.